



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	18.04.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1147/18
PËR/ZA/TO:	z. Sherif HOTI Menaxher i zyrës së Prokurimit Komuna e Obiliqit
CC:	z. Xhafer Gashi Kryetari i Komunës së Obiliqit
NGA/OD/FROM:	z. Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: “Rregullimi i rrugëve me kubëza “Murat Krasniqi”; “Presheva”; “Naser Kastrati”; “Kongresi Manastirit”; “11 Qershori” me nr. të prokurimit OB614/18/2199/521, nr. të brendshëm 614/18/015/521.

I nderuar z. Hoti,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: “Rregullimi i rrugëve me kubëza “Murat Krasniqi”; “Presheva”; “Naser Kastrati”; “Kongresi i Manastirit”; “11 Qershori” me nr. të prokurimit OB614/18/2199/521, nr. të brendshëm 614/18/015/521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: “Rregullimi i rrugëve mr kubëza “Murat Krasniqi”; “Presheva”; ‘Naser Kastrati”; “Kongresi Manastirit”; “11 Qershori” me nr. të prokurimit OB614/18/2199/521, nr. të brendshëm 614/18/015/521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

A r s y e t i m i

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 13 prill 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-1147/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i rrugëve me kubëza “Murat Krasniqi”; “Presheva”; ‘Naser Kastrati”; “Kongresi Manastirit”; “11 Qershori” me nr. të prokurimit OB614/18/2199/521, nr. të brendshëm 614/18/015/521, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Obiliqit.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma E-Prokurimi, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike, llojit punë, me vlerë të mesme të parashikuar 116,669.88€. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur që në njoftimin për kontratë në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses punë të ngjashme në periudhën e shkuar 3 (tri) vjeçare, prej momentit të publikimit të njoftimit për kontratë, minimumi i totalit të vlerës së kontratave të përfunduara duhet të jetë së paku 100,000.00€*”, ndërsa tek dëshmia e kërkuara dokumentare është kërkuar: “*Lista e projekteve të realizuara në periudhën e shkuar 3 (tri) vjeçare duhet të dorëzohet në origjinal e vulosur dhe e nënshkruar nga operatori ekonomik. Lista e projekteve duhet të përmbajë: Emrin e autoritetit kontraktues, titullin e kontratës, vlerën e kontratës. Listës së projekteve të realizuara duhet bashkangjitur dëshmitë e përfundimit të punëve të ngjashme si: Referencat ose procesverbali/et e pranimit të punëve e të cilat duhet të korrespondojnë me listën e kontratave të realizuara, referencat kopje*”, kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 69.

Bazuar në legjislacioni në fuqi konkretisht nenin 69 Aftësitë Teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenin 26.8 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se një autoritet kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kriterëve të përzgjedhjes të kërkoj si dëshmi kontrata dhe referenca me të cilat do ta vërtetonte kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse autoriteti

kontraktues vendos një kërkesë të tillë, për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, duhet të ceket *referenca apo certifikata të autoriteteve publike dhe personave privat*, e jo siç ka vepruar në rastin konkret autoriteti kontraktues duke cekur *lista e projekteve duhet të përmbajë: Emrin e autoritetit kontraktues, titullin e kontratës, vlerën e kontratës*.

Sipas Legjislacioni në fuqi për Prokurim Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 6.2 parashihet se “Për të vërtetuar aftësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, autoriteti kontraktues mundet të kërkojë listën që specifikon secilin nga projektet punuese të operatorit ekonomik dhe aktiviteteve të ndërtimit të kryer nga operatori ekonomik në 3 vitet e fundit të përcjellura me certifikatë të ekzekutimit të mirë që tregojnë vlerën, datën dhe llojin dhe vendin e projektit punuese dhe ose aktiviteteve të ndërtimit/certifikatat e pranimit”.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 27 Dosja e tenderit si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !